



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-PR-2017-03

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 31 maj 2017

Titulli: Referim i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së
Procedurës dhe të Provave bazuar në nenin 19 (5) të Ligjit

PUBLIK

VENDIM

**për caktimin e gjykatësve në një Panel të Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të
Specializuara**

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 33(3) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), me anë të këtij vendimi, cakton Panelin e Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“rregullat e rishikuara”).

1. Më 29 maj 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare nëpërmjet mjeteve të komunikimit (“Plenare”), me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, miratuan rregullat e rishikuara.

2. Më 31 maj 2017, Kryetarja, duke vepruar në bazë të nenit 19(5) të Ligjit, i referoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, rregullat e rishikuara të miratuara në Plenare.¹

3. Në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit, pas referimit në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari cakton tre gjykatës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në përbërje të një Paneli të Gjykatës Kushtetuese (“Paneli”). Në rast pamundësie të kryerjes së detyrës prej njërit nga këta gjykatës, Kryetari cakton një gjykatës kushtetues rezervë.

4. Në përputhje me rregullën 3(3) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë, gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese njoftuan Kryetaren në lidhje me disponueshmërinë e tyre. Gjykatësi Stensland njoftoi Kryetaren për pamundësinë e tij për të kryer detyrën në lidhje me këtë referim. Rrjedhimisht, si gjykatës kushtetues rezervë, gjykatësi Balsamo caktohet në përbërje të Panelit për këtë referim, në përputhje me fjalinë e dytë të nenit 33(3) të Ligjit.

¹ Referim i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, nr. KSC-CC-PR-2017-03, 31 maj 2017.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, NË VIJIM, KRYETARJA

çakton gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në përbërje të Panelit të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II, duke përfshirë edhe nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si më poshtë:

Gjykatëse An Pauër-Ford
Gjykatës Roland Dekers, dhe
Gjykatës Antonio Balsamo.

/Nënshkrim/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E mërkurë, 31 maj 2017

Në Hagë, Holandë.